

# KODI I ETIKËS

Për

## ANËTARËT DHE DREJTORIN EKZEKUTIV TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Publikuar në prill 2023

### A. HYRJE

Nëse nuk përcaktohet ndryshe, ky Kod zbatohet për:

- (i) anëtarët e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit ("anëtarët e KKK-së");
- (ii) drejtorin ekzekutiv (i cili ka shërbyer për një periudhë tre muaj ose më shumë); dhe
- (iii) kandidatët për rolet e mësipërme, veçanërisht në lidhje me kërkesën për të bërë transparencë.

**Qëllimi:** Për të krijuar një grup parimesh dhe praktikash të zbatueshme nga KKK, të cilat do të përcaktojnë parametrat dhe do të sigurojnë udhëzime për sjelljen dhe vendimmarrjen e anëtarëve të KKK-së dhe drejtorit ekzekutiv.

**Kodi:** Anëtarët e KKK-së dhe drejtori ekzekutiv janë të përkushtuar të respektojnë dhe promovojnë standardet më të larta të sjelljes etike në kryerjen e përgjegjësive të tyre. Anëtarët e KKK-së dhe drejtori ekzekutiv zotohen të pranojnë këtë kod si një udhëzues minimal për sjellje etike dhe secili:

#### Përgjegjshmëria:

- Respekton me besnikëri aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë funksionimin dhe organizimin e KKK-së;
- Ushtron një kujdes të arsyeshëm, mirëbesim dhe kujdes të duhur në çështjet që lidhen me KKK-në;
- Paraqet të plotë, në rastin më të hershëm, rastet që mund të rezultojnë në një perceptim të konfliktit aktual të interesit; Sa herë që një anëtar i KKK apo drejtori ekzekutiv i KKK, gjatë trajtimit të një rasti të caktuar, ndodhet në konflikt interesi, ai/ajo duhet të plotësojë një formular vetëdeklarimi në të cilin të paraqesë këtë konflikt dhe rrethanat e ndodhjes së tij.
- Paraqet të plotë, në rastin më të hershëm, informacionin për faktet që do të kishin rëndësi në vendimmarrjen e KKK-së.

#### Shanset e barabarta:

- Siguron të drejtën e të gjitha palëve të interesuara për shërbime të përshtatshme dhe efektive pa diskriminim në bazë të gjeografisë, karakteristikave politike, fetare ose socio-ekonomike të palës së përfaqësuar;
- Siguron të drejtën e të gjithë stafit të punësuar për trajtime të përshtatshme dhe efektive, pa diskriminim në lidhje me gjininë, orientimin seksual, origjinën, racën, fenë, moshën, përkatësinë politike ose aftësinë e kufizuar, në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

#### Ekspertizën profesionale:

- Mban një nivel profesional mirësjelljeje, respekti dhe objektiviteti në të gjitha aktivitetet e KKK-së;
- Përpiqet të përkrahë ato praktika dhe të ndihmojë të tjerët në mbrojtjen e standardeve më të larta të sjelljes.

Parimi i kompetencës profesionale dhe i kujdesit të duhur imponon mbi anëtarët e KKK-së dhe drejtorin ekzekutiv detyrimin që të zotërojnë njohuri dhe aftësi profesionale në nivelin që kërkohet për të garantuar që vendimmarrja e tyre do jetë profesioniste dhe me kompetencën e duhur.

Kujdesi përfshin përgjegjësinë për të vepruar në pajtim me kërkesat e një detyre të caktuar, me vëmendje, plotësisht dhe në afatet e duhura kohore.

#### *Bashkëpunimin dhe bashkëveprimin:*

9. Respekton larminë e mendimeve të anëtarëve të tjerë dhe drejtorit ekzekutiv, komiteteve dhe personelit të punësuar dhe regjistrohen zyrtarisht mosmarrëveshjet sipas rastit.

10. Promovon bashkëpunim, bashkëveprim dhe partneritet midis anëtarëve të KKK-së.

11. Promovon bashkëpunim, bashkëveprim dhe partneritet midis institucionit të KKK-së dhe organizmave të tjerë lokalë apo ndërkombëtarë.

## **B. TË PËRGJITHSHME**

1. Parimet kryesore mbi të cilat bazohet ky Kod i Etikës, janë shtatë parimet e jetës publike.

### ***Vetëmohimi***

Mbajtësit e detyrave publike duhet të veprojnë vetëm në terma të interesit publik.

### ***Integriteti***

Mbajtësit e funksioneve publike duhet të shmangin vendosjen e tyre nën ndonjë detyrim ndaj njerëzve ose organizatave që mund të përpiqen në mënyrë jo të duhur për t'i ndikuar ata në punën e tyre. Ata nuk duhet të veprojnë ose të marrin vendime në mënyrë që të sigurojnë përfitime financiare ose materiale të tjera për veten e tyre, familjen ose miqtë e tyre. Ata duhet të deklarojnë dhe zgjidhin çdo marrëdhënie interesi.

Anëtari i KKK-së si dhe drejtori ekzekutiv nuk duhet të ketë lidhje me dokumentacionin, komunikimet apo me informacione të tjera, kur krijohet bindja se ky informacion: (a) Përmban një deklaram fals ose një deklaram që keqduhëzon; (b) Përmban materiale ose informacione që janë marrë në mënyrë të nxituar; ose (c) Lë jashtë apo fsheh informacionin e kërkuar që duhej të ishte i përfshirë, kur kjo lënie jashtë ose fshehje është keqduhëzuese (çorientuese).

### ***Objektiviteti***

Mbajtësit e funksioneve publike duhet të veprojnë dhe të marrin vendime të pavarura, të drejta dhe mbi baza merite duke përdorur evidencën më të mirë pa paragjykime apo diskriminime të çfarëdolloji. Parimi i objektivitetit imponon detyrimin për të gjithë anëtarë e KKK-së si dhe drejtorin ekzekutiv që ata të mos kompromentojnë gjykimin e tyre profesional për shkak të paragjykimit, konfliktit të interesave ose të influencës së tepruar të të tjerëve.

### ***Përgjegjshmëria manaxheriale***

Mbajtësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen kontrollit të nevojshëm për ta siguruar këtë.

### ***Transparenca***

Mbajtësit e funksioneve publike duhet të veprojnë dhe të marrin vendime në mënyrë të hapur dhe transparente. Publiku duhet të ketë akses në këtë informacion përveç nëse ka arsye të qarta dhe të ligjshme për të vepruar kështu.

### ***Ndershmëria***

Mbajtësit e funksioneve publike duhet të jenë të ndershëm dhe të thonë gjithnjë vetëm të vërtetën.

### ***Drejtimi***

Mbajtësit e funksioneve publike duhet t'i shfaqin këto parime në sjelljen e tyre. Ata duhet të promovojnë dhe mbështesin në mënyrë aktive parimet dhe të jenë të gatshëm të sfidojnë sjelljen e dobët kudo që të ndodhë.

## **2. Rregullat e sjelljes në KKK**

Për të promovuar pajtueshmërinë me Kodin e Sjelljes, rregullat e sjelljes në vijim janë të zbatueshme për anëtarët e KKK-së dhe drejtorin ekzekutiv dhe, në masën e parashikuar në mënyrë specifike, për bashkëshortët dhe anëtarët e familjes.

### ***Objektiviteti dhe pavarësia***

Një nga objektivat kryesorë të funksionimit dhe organizimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit është hartimi dhe përmirësimi i standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar që synojnë cilësinë, pavarësinë, objektivitetin dhe transparencën e informacionit financiar të publikueshëm.

Prandaj, është me rëndësi të madhe të mos ketë konflikte nga njëra anë, midis interesave private dhe personale të anëtarëve të KKK-së dhe drejtuesit ekzekutiv të saj, dhe interesit publik ndaj KKK-së nga ana tjetër.

Anëtarët e KKK-së dhe drejtuesi ekzekutiv duhet të jenë gjithnjë të vëmendshëm ndaj përgjegjësiave të tyre publike, ndjeshmërisë së pozicioneve të tyre dhe nevojës për besim të publikut në ndershmërinë e procesit vendimmarrës të KKK-së. Në përputhje me rrethanat, ata duhet të kujdesen shumë të rregullojnë qëndrimin dhe sjelljen e tyre si dhe të gjitha aktivitetet që ata ndërmarrin, në atë mënyrë që investimet e tyre personale dhe aktivitetet e tjera personale dhe profesionale të mos ndikojnë në pavarësinë ose objektivitetin e tyre si pjesë e KKK-së ose të jenë të dëmshme për interesat ose reputacionin e KKK-së.

Në këtë drejtim, anëtarët e KKK-së dhe drejtori ekzekutiv duhet të kuptojnë që pavarësia dhe objektiviteti janë kryesisht cilësi subjektive dhe njerëzitet që vlerësojnë mbi fakte, mundet që në mirëbesim të arrijnë në përfundime të ndryshme për sa i përket ekzistencës së tyre, apo mos ekzistencës, në një rast të veçantë. Shkalla e besimit të publikut në funksionet dhe aktivitetet e KKK-së do të varet ndjeshëm nga respektimi me korrektësi, në gërmë dhe në frymë, të këtyre politikave.

### ***Përgjegjësitë si anëtar i KKK-së***

Çdo anëtar duhet të luajë një rol aktiv në detyrat dhe veprimtaritë e KKK-së duke përmbushur në kohë detyrat dhe përgjegjësitë dhe duke vepruar në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të KKK-së;

Çdo anëtar duhet të promovojë një kulturë gjithëpërfshirëse në KKK dhe veprimet duhet të ndihmojnë në krijimin e një mjedisi ku këndvështrimet dhe prejardhjet e ndryshme inkurajohen dhe vlerësohen.

Çdo anëtar duhet të merret me detyrat publike dhe veprimtarinë e vet në mënyrë të drejtë, efikase, efektive dhe të ndjeshme, duke dhënë maksimumin e aftësive personale. Nuk duhet të veprohet në atë mënyrë që padrejtësisht favorizon ose diskriminon individë ose interesa të veçantë.

Çdo anëtar nuk duhet të ngacmojë, bullizojë ose të veprojë në mënyrë jo të duhur ose të diskriminojë të tjerët. Një sjellje e tillë nuk është në përputhje me atë që pritet nga një anëtar i KKK-së dhe nuk do të tolerohet.

Çdo anëtar duhet të respektojë parimin e vendimmarrjes kolektive. Kjo do të thotë që, pasi KKK të marrë një vendim, duhet ta mbështesë atë vendim.

### ***Përgjegjësitë ndaj stafit administrativ të punësuar***

Anëtarët e KKK-së dhe drejtori ekzekutiv do të trajtojnë çdo të punësuar nga KKK me mirësjellje dhe respekt. Pritet që punonjësit të tregojnë të njëjtën konsideratë si kthim.

Anëtarët e KKK-së dhe drejtori ekzekutiv nuk do t'i kërkojnë ose inkurajojnë punonjësit të veprojnë në asnjë mënyrë që mund të bjerë ndesh me Rregulloren për funksionimin e strukturës administrative të KKK-së.

### ***Përfshirja në aktivitete politike***

Si mbajtës i një funksioni publik, anëtarët e KKK-së dhe drejtori ekzekutiv duhet të jenë politikisht të paanshëm. Në varësi për sa më sipër, anëtarët e KKK-së dhe drejtori ekzekutiv mund të përfshihen në aktivitete politike, por gjithnjë duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre dhe të ushtrojnë diskrecionin e duhur.

### ***Të tjera***

Anëtarët e KKK-së dhe drejtori ekzekutiv duhet të sigurohen që KKK-ja të ketë një mjedis të hapur, transparent dhe të sigurt pune ku punonjësit mund të flasin hapur dhe të ngrenë shqetësime. Gjithashtu duhet të sigurohen që procedurat e ankesave t'u komunikohen qartë anëtarëve të stafit.

Nëse ndonjë nga Anëtarët e KKK-së ose drejtori ekzekutiv ka një shqetësim për një shkelje të mundshme të këtij Kodi, atëherë ata kanë përgjegjësinë ta ngrenë çështjen gjatë mbledhjes së radhës së këtij Këshilli, për t'u trajtuar dhe përshkallëzuar, sipas rastit.

### ***Rregulli i Përgjithshëm i Konfliktit të mundshëm të Interesit***

Asnjë Anëtar i KKK-së apo drejtori ekzekutiv nuk mund të veprojnë në një mënyrë të tillë që, *pavarësisht se nuk është e ndaluar në mënyrë specifike në këtë dokument*, në mënyrë të arsyeshme të rezultojë ose të krijojë shfaqjen e:

- (a) Shfrytëzimit të pozicionit zyrtar në KKK për përfitime private;
- (b) Dhënies së një trajtimi preferencial personave të veçantë në cilësinë e anëtarit apo drejtuesit ekzekutiv në KKK;
- (c) Humbjes së pavarësisë apo objektivitetit personal gjatë punës dhe për çështje që kanë lidhje me KKK-në;
- (d) Ndikimit negativ në besimin e publikut tek integriteti, pavarësia ose objektiviteti i KKK-së, ose në të kundërt të qenit i dëmshëm për interesat ose reputacionin e KKK-së.

Sa herë që një anëtar i KKK apo drejtori ekzekutiv i KKK-së, gjatë trajtimit të një rasti të caktuar, ndodhet në konflikt interesi, ai/ajo duhet të bëjë vetëdeklarimin në të cilin të paraqesë këtë konflikt dhe rethanat e ndodhjes së tij dhe të tërhiqet nga vendimmarrja përpara trajtimit të rastit.

### ***Marrëdhëniet me punëdhënësit, partnerët dhe të tjerë: Interesat familiare***

Anëtarët e KKK-së dhe drejtori ekzekutiv duhet të jenë të ndjeshëm ndaj mundësisë që marrëveshjet financiare apo të tjera marrëveshje që përfshijnë bashkëshortin ose anëtarët e familjes mund të ndikojnë ose të krijojnë në mënyrë të arsyeshme pamjen e ndikimit të pavarësisë ose objektivitetit të tyre.

### ***Investimet***

Investimet, duke përfshirë zotërimin ose mbajtjen e letrave me vlerë, të pasurive të patundshme, opsioneve future dhe forëard si dhe pasuri të tjera të mbajtura për qëllime investimi personal, nga anëtarët e KKK, drejtori ekzekutiv, bashkëshortët e tyre dhe anëtarët e familjes nuk janë të ndaluara nga këto politika. Sidoqoftë, anëtarët e KKK-së dhe drejtori ekzekutiv (dhe bashkëshortët dhe anëtarët e familjes mbi të cilët anëtarët e KKK-së ose drejtori ekzekutiv mund të ushtrojnë kontroll) duhet të shmangin përfshirjen në angazhime spekulative që mund të çojnë në kohë në kërkesa të paarsyeshme, shqetësime ose vështirësi financiare.

Anëtarët e KKK-së dhe drejtori ekzekutiv duhet që në çdo kohë të jenë të ndërgjegjshëm për karakterin publik të përgjegjësive të tyre dhe duhet të kujdesen për të shmangur, dhe kudo që të jetë e mundur të ndërmarrin hapa që mund të jenë praktikisht të arsyeshëm sipas rrethanave për të minimizuar përfshirjen financiare që mund të ndikojë ose të krijojë në mënyrë të arsyeshme pamjen e ndikimit në pavarësinë ose objektivitetin e tyre.

### ***Informacioni jo publik***

Anëtarët dhe drejtori i KKK-së nuk duhet, direkt ose indirekt, të përdorin ose të vendosen në një situatë, për të përfituar personalisht prej saj, ose, direkt ose indirekt, të bëjnë të ditur ose të vënë në dispozicion të të tjerëve (përveç siç kërkohet nga punësimi dhe detyrat e tyre), çdo informacion që mund të konsiderohet si material që ka të bëjë me funksionet ose veprimtaritë e KKK-së, të siguruara gjatë afatit si anëtar apo punësimin të tyre që nuk janë publikuar, shpallur ose vënë në dispozicion të publikut.

### ***Media sociale***

Media sociale është një forum publik dhe të njëjtat konsiderata, përfshirë paragrafët e këtij Kodi, zbatohen kur ka një komunikim publik ose është përgatitur një shkrim për publikim, qoftë zyrtarisht ose si angazhim personal. Kur anëtarët e KKK-së ose drejtori ekzekutiv angazhohen në media sociale, duhet të respektojnë çdo herë konfidencialitetin, informacionin financiar, ligjor dhe personal.

Kur ndonjë anëtar i KKK-së apo drejtori ekzekutiv ka llogari personale në rrjete sociale dhe duke e përdorur i referohet rolit publik, duhet bërë kujdes që të sigurohet që është e qartë në çfarë cilësie po vepron.

### ***Fjalimet dhe diskutimet***

Anëtarët dhe drejtori i KKK-së mund të bëjnë fjalime dhe të shkruajnë materiale për botim, dhe mund të pranojnë rimbursimin nga KKK për shpenzimet e bëra në lidhje me ndonjë fjalim ose shkrim të tillë, por çdo tarifë tjetër, honorar, apo pagesa të tjera si shpërblime në lidhje me publikimet, që bëhen në kuadër të funksionit që ka në institucion dhe publikimi është financuar prej institucionit, do të kalojnë për llogari të KKK-së.

### ***Dhuratat, argëtimet dhe gjëra të tjera me vlerë***

Asnjë anëtar ose drejtor i KKK-së, direkt ose indirekt, nuk kërkon ose pranon ndonjë dhuratë të vlefshme, falenderim, favor, argëtim, shërbim ose ndonjë send tjetër me vlerë monetare nga çdo person që ka interesa që mund të preken materialisht nga performanca ose mos-performanca e detyrave zyrtare të anëtarit ose drejtorit të KKK-së.

Pavarësisht nga sa më sipër, ky rregull nuk do të ndalojë marrjen rastësisht të sendeve të karakterit të mësipërm, të cilat kanë një vlerë monetare më të vogël se 10,000 Lekë (ose ekuivalentin e), dhe nuk do të zbatohen:

- (i) kur rrethanat janë të qarta që marrëdhëniet familjare ose shoqërore, për më tepër interesat e biznesit të personave në fjalë, janë faktorët motivues;
- (ii) kur ushqimi dhe pije freskuese ofrohen falas në një rast thjesht familjar ose shoqëror ose në rrjedhën e zakonshme të një takimi ose biznesi tjetër ku pjesëmarrja është e domosdoshme;
- (iii) për memorandumet, suvenirët ose çmimet, reklamat ose materialet promovuese (siç janë stilolapsat, lapsat, fletoret, kalendarët dhe sendet e tjera), shkrimet teknike dhe materialet e tjera të tilla; dhe
- (iv) kur refuzimi i një oferte do të dëmtonte marrëdhëniet e vazhdueshme profesionale dhe drejtori ekzekutiv ka dhënë autorizim.

### **3. Procedura të tjera individuale**

#### ***Heqja dhe përfundimi i pavullnetshëm***

Në përputhje me ligjin e kontabilitetit, neni 25, pika 7, një Anëtar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit i hiqet mandati para përfundimit të tij, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, vetëm në rastet kur ai:

- a) vdes;
- b) jep dorëheqjen;
- c) bëhet i paaftë për shkak sëmundjeje;
- ç) kryen një vepër penale;
- d) nuk përmbush kërkesat e caktuara në rregulloren e brendshme të KKK-së.

Shkeljet nga një anëtar i KKK-së, konsiderohet se sjellin dëm për qëllimet ose reputacionin e KKK-së dhe përbëjnë bazën për heqjen ose përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit.

#### ***Pensionimi, dorëheqja dhe përfundimi vullnetar***

Duke pasur parasysh peshën dhe rëndësinë publike të kompetencave, funksioneve dhe veprimtarive të KKK-së, pritet që anëtarët e KKK-së të njoftojnë për datën e daljes në pension, dorëheqjen ose përfundimin vullnetar të emërimit të tyre, para skadimit të mandatit të tyre ose në skadimin e mandatit të tyre nëse kanë të drejtë rizgjedhjeje. Ata do të njoftojnë Kryetarin e KKK-së në datën më të shpejtë të mundshme, dhe në çdo rast para se të bisedojnë ose të fillojnë diskutimet në lidhje me çdo punësim të ardhshëm, partneritet biznesi, konsulencë ose marrëveshje të ngjashme.

Konsiderata të ngjashme vlejnë edhe për drejtorin ekzekutiv. Kështu, pritet që drejtori që mendon për pension, dorëheqje ose ndërprerje vullnetare të punës, do të njoftojë në datën sa më të shpejtë të mundshme, përveç rastit të akademikëve në pushim të përkohshëm nga institucionet arsimore, dhe në çdo rast para se të negociojë ose të fillojë diskutimet në lidhje me çdo punësim të ardhshëm, partneritet biznesi, konsulencë ose marrëveshje të ngjashme.

### ***Tërheqja nga votimi***

Nëse në çdo kohë, një anëtar ose drejtori ekzekutiv i KKK-së ndjen se ai vetë ose bashkëshorti i këtij anëtari të KKK-së ose drejtorit ose një anëtar tjetër i familjes, mund të kenë një interes të drejtpërdrejtë financiar ose një interes financiar indirekt, ose një marrëdhënie tjetër, që mund të ndikojë ose të krijojë në mënyrë të arsyeshme pamjen e ndikimit në pavarësinë ose objektivitetin e anëtarit ose drejtorit të këtij anëtari të KKK-së-së në lidhje me qëllimet e tyre, funksionet ose aktivitetet e tanishme të KKK-së, atëherë një anëtar i tillë ose drejtori i KKK-së, në kohën më të shpejtë të mundshme, do të japin informacion për rrethana të tilla dhe të gjitha faktet përkatëse, duhet të jenë të disponueshme sipas vetëdeklarimit të konfliktit të interesit.

Çdo vendim që rezulton në tërheqje nga votimi ose nga funksione ose aktivitete specifike, do t'i komunikohet anëtarit sa më shpejt që të jetë e mundur. Njoftimi në kohën më të shpejtë të mundshme është veçanërisht i rëndësishëm për rastet që përfshijnë një votim për publikimin e një draft ekspozimi, një qëndrimi përfundimtar ose një draft interpretimi apo interpretim përfundimtar. Pavarësisht nga tërheqja nga votimi, një anëtar i KKK-së megjithatë mund të vazhdojë të marrë pjesë në mbledhjet dhe diskutimet që bëhen për çështjet që ai nuk ka të drejtën të votojë.